

KUR PUNONJËSIT SHËNDETËSORË JANË NË PUSHIM MJEKËSOR, KJO MUND TË SHKAKTOJË ÇRREGULLIM TË KUJDESIT PËR PACIENTËT

Mungesa e personelit gjatë sezonit të gripit mund të ketë efekte negative ndaj kujdesit për pacientët dhe të rrisë shpenzimet e kujdesit shëndetësor. Nëse një numër i madh i punonjësve shëndetësorë marrin pushim mjekësor për shkak të gripit, kjo mund të shkaktojë çrregullim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT ËSHTË MËNYRA MË E MIRË PËR T'U MBROJTUR NGA GRIPIT.

OBSH REKOMANDON VAKSINIMIN KUNDËR GRIPIT SEZONAL TË TË GJITHË PUNONJËSVE SHËNDETËSORË, ÇDO VIT.



E RËNDËSISHME!

VAKSINIMI PËR PUNONJËSIT SHËNDETËSORË ËSHTË FALAS!

ÇAKTONI TERMIN PËR VAKSINIM NËPËRMJET PLATFORMËS ONLINE!

Caktimi i termineve për vaksinim me vakcina falas bëhet nëpërmjet ueb-faqes www.vaksinacija.mk

Me plotësimin e formularit ju regjistroheni për vaksinim drejtpërdrejt në sistemin Termini Im. Me anë të një mesazhi SMS ju do të informoheni për datën dhe orën e saktë të vaksinimit në pikën e vaksinimit që e keni zgjidhur gjatë regjistrimit.

Përveç këtyre vaksinave, ju mund të vaksinoheni me vakcina komerciale kundër gripit sezonal në Qendrën më të afërt të Shëndetit Publik pa caktuar paraprakisht një termin.

VAKSINA KUNDËR GRIPIT ËSHTË E SIGURTË, APLIKOHET MË SHUMË SE 60 VJET DHE DERI MË TANI NË BOTË JANË VAKSINUAR ME MILIONA NJERËZ.

Nëse jeni punonjës shëndetësor,

VAKSINOHUNI KUNDËR GRIPIT!

PUNONJËSIT SHËNDETËSORË JANË NË RREZIK MË TË MADH NGA INFERTIMI ME GRIP



Për shkak të natyrës së punës së tyre punonjësit shëndetësorë janë 10 herë më të rrezikuar nga infektimi me grip sesa popullata e përgjithshme. Nëse jeni punonjës shëndetësorë, ju mund të infektoheni me grip nga pacientët ose kolegët tuaj. Sipas disa studimeve është dëshmuar se gjatë një epidemie, në institucionet shëndetësore, më shumë se gjysma e punonjësve shëndetësorë që kujdesen për pacientët me grip edhe vetë janë të infektuar me virusin. Gripi është një sëmundje serioze, mund të shkaktojë pneumoni, bronkit ose të përkeqësojë sëmundjet ekzistuese kronike shëndetësore. Vaksinimi kundër gripit për çdo vit është mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga gripi.

VAKSINOHUNI!



KUR JENI TË SËMURË ME GRIP, JU MUND TA TRANSMETONI ATË TEK PACIENTËT TUAJ

Ka studime që tregojnë se punonjësit shëndetësorë mund ta transmetojnë gripin te pacientët e tyre, veçanërisht nëse ata janë të ndjeshëm ndaj zhvillimit të komplikimeve. Gripi është i rrezikshëm për fëmijët e vegjël, të rriturit dhe njerëzit me imunitet të dobësuar ose sëmundje të tjera kronike. Si rezultat i transmetimit të gripit nga punonjësit shëndetësorë, disa pacientë mund të zhvillojnë komplikime të rrezikshme për jetën, siç janë rastet e dokumentuara të vdekjes nga gripi në qendrat e kujdesit intensiv neonatal dhe repartet e onkologjisë pediatrike.

GRIPË MUND TË JETË NJË SËMUNDJE SERIOZE DHE TË SHKAKTOJË KOMPLIKIME DHE HOSPITALIZIM

PUNONJËSIT SHËNDETËSORË JANË TË PËRKUSHTUAR NDAJ PUNËS. ATA SHPESH SHKOJNË NË PUNË EDHE PSE JANË TË SËMURË, ME ÇKA E RRISIN RREZIKUN E TRANSMETIMIT TË GRIPIT.



**MBRONI VETEN!
MBRONI PACIENTËT TUAJ!
MBRONI TË AFËRMIT TUAJ!**

Disa njerëz nuk shfaqin simptoma të gripit, kështu që ata mund ta përhapin virusin e gripit pa e ditur se janë të infektuar, edhe pse nuk ndihen të sëmurë. Në një studim gjysma e punonjësve shëndetësorë me grip nuk e dinin se ishin bartës të virusit. Mirëpo, nëse vaksinoheni kundër gripit, mund të jeni të qetë sepse gjasat që t'i infektoni pacientët tuaj që janë të ndjeshëm janë shumë më të vogla.